



NJOFTIM

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, shpall konkursin për 10 vende të reja pune për personel akademik me kohë të plotë në Filialin e Peshkopisë, sipas fakulteteve dhe specialiteteve si më poshtë. Qendra e punës do të jetë në qytetin e Peshkopisë.

1. Shkolla e Lartë Profesionale 5 vende ;

1.1 <u>Specialiteti:</u>	a – Informatikë	2	vende
	b – Matematikë	2	vende
	c – Fizikë	1	vend

2. Fakulteti i Edukimit 3 vende;

2.1 <u>Specialiteti:</u>	a - Gjuhë Angleze	2	vende
	c - Gjuhësi –Letërsi	1	vend

3. Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit 2 vende :

A. Të interesuarit për vendet e mësipërme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtëme:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta në specialitetin e kërkuar. Preferohen personat që kanë mbaruar: Diplomë të Nivelit të Dytë, Master të Nivelit të Dytë dhe/ose Doktor në specialitetin përkatës.
2. Të jetë i aftë të garantojë vlerësimin, efikasitetin dhe ekselencën e lëndëve që do të japë.
3. Të ketë njohuri mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.
4. Të njohë dhe të jetë familjar me sistemin e funksionimit të universiteteve perëndimore dhe të Kartës së Bolonjës.

B. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e aplikimit për personel akademik i cili mund të shkarkohet në faqen e internetit të universitetit në adresën www.uamd.edu.al, ose të tërhiqet dorazi në zyrën e Degës së Burimeve Njerëzore të universitetit;
2. Tre letra rekomandimi nga pedagogë apo udhëheqës shkencor të kandidatit dhe të paktën një nga tre letrat të jetë nga punëdhënësi / drejtuesi i fundit nëse ka një të tillë;
3. Fotokopje të diplomës, të noterizuar;
4. Fotokopje të çertifikatës së notave të noterizuar;
5. Fotokopje të dëshmimeve kualifikimi të ndryshme, të noterizuara;
6. Fotokopje të artikujve shkencorë të publikuar në revista ndërkombëtare profesionale / shkencore dhe / ose punime të tjera;

7. Fotokopje të pasaportës ose të një dokumenti identifikimi;
8. Programi / et (syllabus) e lëndës / ve për të cilën / at kandidati aplikon.
9. Deklaratë nga kandidati aplikues për gjëndjen gjyqësore.

Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, duhet të jenë të përkthyer dhe të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38.

- C. Afati i fundit i pritjes aplikimeve është deri në 31.08.2010. Do të shqyrtohen vetëm paketat e aplikimit që përmbushin kriteret e sipërpërmendura.**
- D. Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë dokumentacionin përkatës, në adresën;**
Universiteti “Aleksandër Mosiu”
Për Filialin e Peshkopisë
Fakulteti: _____
Departamenti: _____
Specialiteti: _____
Lagja 1, Rruga e Currilave, Durrës.
- E. Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.**
- F. Proçedura e përzgjedhjes së kandidaturave fillon menjëherë pas publikimit të këtij njoftimi dhe do të zhvillohet sipas Udhëzimit Nr. 129, datë 30.01.2009 “Për përzgjedhjen dhe rekrutimin e personelit akademik, ndihmës mësimor – shkencor dhe administrativ, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.**